

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-CLRR-032
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 1 nga 20</i>

20.01.2016

Azhurnimet Vjetore të Shqyrtimit të Shtatë të Tarifave të Energjisë Elektrike

Propozimi për Të Hyrat e Lejuara për Vitin 2016

Janar 2016

Parafrimimi

1.0	Hyrje.....	3
2.0	Të Arriturat e KOSTT gjatë Vitit 2015.....	3
3.0	Të Hyrat.....	4
4.0	Shpenzimet Kapitale	5
4.1	Projektet e reja gjatë vitit 2015.....	5
4.2	Projektet e reja të vitit 2016	10
5.0	Shpenzimet Operative	11
5.1	Shpenzimet e Personelit.....	12
5.2	Shpenzimet e Mirëmbajtjes	12
5.3	Shpenzimet tjera operative	13
5.4	Shpenzimet e Humbjeve në Transmision	13
5.5	Shpenzimet e Shërbimeve Ndihmëse	15
5.6	Faktori i Efikasitetit.....	17
6.0	Mekanizmi i kompensimit ndër TSO- Mekanizmi i ITC	18
7.0	Përmbledhje	18

1.0 HYRJE

Zyra e Rregullatorit të Energjisë me datën 11 nëntor 2015 ka iniciuar procesin e azhurnimit vjetor të shqyrtimit të tarifave të energjisë elektrike për vitin 2016.

Bazuar në obligimet që dalin nga Rregulla e Çmimeve për OST/OT-në, KOSTT në vijim paraqet raportin për shpenzimet dhe të hyrat e realizuara gjatë viti 2015, si dhe kërkesat në këto pozicione për vitin 2016.

Raportimi për Realizimin e Vitit 2014 është bërë sipas Vitit Kalendarik 1 janar 2015 – 31 dhjetor 2015.

Kërkesa për vitin 2016 është bërë në bazë të Buxhetit të Aprovuar për vitin 2016.

2.0 TË ARRITURAT E KOSTT GJATË VITIT 2015

Ne vazhdimësi të viteve të mëparshme që nga themelimi KOSTT ka vazhduar trendin e rezultateve pozitive, pra edhe në vitin 2015 janë arritur suksese në të gjitha sferat e veprimit dhe duke vazhduar zhvillimin në reference me transmise të shteteve evropiane si dhe duke u bërë model për ato në rajon.

Ndër të arriturat gjatë vitit 2015 që kërkojnë theks të veçantë janë:

- Përfundimi para afatit të planifikuar të Projektit të Linjës 400 kV Kosovë-Shqipëri
- Implementimi i Projektit për LFC, testimi me sukses KOSTT-OST
- Implementimi i Projektit linja 110 kV NS Gjakova 1 – NS Gjakova 2
- Nënshkrimi i Marrëveshjes për Shërbime Ndihmëse me Shqipërinë
- Nënshkrimi i Marrëveshjes për Kycje të Sistemit Elektroenergjetik të Kosovës në Zonën Sinkrone të Evropës Kontinentale , në mes të KOSTT dhe ENTSO-E
- Pranimi i KOSTT në Mekanizmin ITC
- Plotësimi dhe kalimi me sukses i pyetësorit që rrjedhe nga Doracaku i operimit nga ENTSO-E në lidhje me vlerësimin e Përputhshmërisë së Standardeve teknike të operimit . Vlerësimi i këtyre standardeve teknike është e bërë nga grupi punues i eksperteve të ENTSO-E
- Funkcionalizimi i Zonës Observuese me TSO-t regjionale në sistemin SCADA-EMS
- Testimi me sukses i Platformës së TI të Tregut

- Testimi me sukses i Skedulimit dhe Accounting
- Testimin me sukses i DACF

Gjatë vitit 2015, performanca operative e KOSTT-it ishte mjaft e mirë dhe tregon përmirësim të vazhdueshëm. Janë bërë avancime në ngritjen e funksioneve operative në monitorimin dhe veçmas në operimin e sistemit në kohën reale. Sistemi infrastrukturor SCADA\EMS, i Telekomit dhe Matjeve komerciale ofrojnë mundësi shumë më të avancuara për operim të sigurisë së lartë, në baza planifikuese dhe në kohë reale, këmbimin e të dhënave midis objekteve elektro-energetike, TSO-ve fqinje dhe Qendrës Koordinative të Bllokut Rregullues.

Infrastruktura e matjeve komerciale ka përmirësuar në masë të konsiderueshme leximin e të dhënave kumulative të energjisë elektrike në të gjitha pikat kufitare të rrjetit transmetues përmes përdorimit të Fibre Optikut në pronësi të KOSTT-it.

Si rezultat i angazhimeve në këtë drejtim, nuk ka pasur ankesa për tension nga konsumatorët, ndërsa devijimet e sistemit kanë qenë më të ulëta.

Ofrimi i shërbimeve kualitative dhe të besueshme për përdoruesit e sistemit të transmissioinit, padyshim është në mesin e detyrave të KOSTT dhe është në përputhje me objektivat e saj strategjike. Sa i përket përmbushjes së kësaj detyre, performanca e operimit të sistemit të transmissioinit në vitin 2015, ka pasur ngritje të theksuar.

Linjat dhe nënstacionet janë mirëmbajtur sipas planit të paraparë, duke realizuar planin vjetor të mirëmbajtjes së linjave dhe mirëmbajtjes së nënstacioneve. Janë kryer kontrollimet/inspektimet, remontet, testimet e mbrojtjeve rele, si dhe intervenimet dhe evitimi i prishjeve. Përveç kësaj janë zhvilluar edhe aktivitete tjera jashtë aktiviteteve të planifikuara, që kanë ndikuar në ngritjen e performancës së operimit të transmissioinit.

Në përmbushjen e objektivave të KOSTT një nga të cilat është edhe integrimi rajonal, KOSTT ka vazhduar edhe më tutje të ballafaqohet me shumë sfida që janë paraqitur në procesin e integritimit në mekanizmat rajonal, duke u angazhuar maksimalisht, sidomos në negociimin e marrëveshjes operative mes KOSTT dhe TSO-ve fqinje. Po ashtu, janë zhvilluar aktivitetet e grupit punues në lidhje me marrëveshjen e kyçjes me ENTSO/E.

Ka filluar implementimi i projekteve që financohen nga KfW në kuadër të-Programit IV dhe V të Sektorit, në mesin e të cilave është edhe projekti për instalimin e autotransformatorit të dytë 300 MVA në NS 400/110 kV Ferizaj 2 dhe NS 400/110 kV Peja3, etj.

KOSTT edhe një herë ka dëshmuar përkushtimin e saj që të ruaj performancën e lartë financiare, duke përfunduar Raportin e Auditorit të Jashtëm për Auditimin e Pasqyrave Financiare për vitin 2014, sipas standardeve ndërkombëtare dhe pa asnjë kualifikim.

3.0 TË HYRAT

Në bazë të Vendimit të Bordit të ZRrE-së, me nr. V_717_2015 të datës 03.04.2015, të Hyrat e Lejuara për vitin tarifar 2015 për KOSTT kanë qenë 25,764,270 €.

Në tabelën e më poshtë mund të shihen të dhënat për të hyrat e lejuara dhe të realizuara për vitin kalendarik 2015.

Tabela 1. Të Hyrat e Lejuara dhe të Realizuara në vitin kalendarik 2015

Viti Kalendarik 2015	Njësia	Lejuar	Realizuar	Ndryshimi	%
Të Hyrat Totale	€'000	25,764.269	23,860.273	(1,903.996)	93%
TNUOS	€'000	15,499.518	15,225.613	(273.905)	98%
SO	€'000	9,908.467	8,299.706	(1,608.761)	84%
MO	€'000	356.284	334.954	(21.330)	94%

Shihet se në total të hyrat e realizuara janë 7% më të ulëta se ato të lejuara. Kjo ka ndodhur për shkak të dallimit në mes të viti tarifar dhe vitit kalendarik, ku në vitin kalendarik të hyrat për tre muajt e parë janë nga tarifat e vitit të kaluar të cilat kanë qenë më të vogla se sa tarifat e vitit 2015. Gjithashtu faktor ndikues janë edhe rrjedhat e energjisë në bazë të të cilave mbledhen të hyrat e SO dhe MO.

4.0 SHPENZIMET KAPITALE

Si edhe viteve të tjera, edhe viti 2015 ka qenë vit i realizimit të projekteve, të cilat kanë filluar në vitet e mëhershme, pra projekteve në vazhdimësi, përgatitja e Termave të Referencës dhe Specifikimeve Teknike për projektet e reja, si dhe fillimi me implementim të projekteve të reja. Shpenzimet Kapitale për vitin 2015 janë realizuar 34,133,618.96€. Ndërsa për vitin 2016 të planifikuara janë 34,826,206.14€. Këto të dhëna janë të bazuara sipas vlerës së aseteve.

Në vazhdim paraqiten arsyetimet e projekteve të reja të cilat janë në implementim ose parashihen për vitin 2016, të cilat nuk janë pjesë e Planit Investiv 2013 – 2017 por gjatë rrugës është paraqitur nevoja për këto investime.

4.1 Ngritja e vlerës së projekteve

Më poshtë janë paraqitur projektet vlera e të cilave ka ndryshuar krahasuar me Planin Investiv 2013-2017

- **Paket Projekti: LOT 1 “LP 400kV Kosovë – Shqipëri”, vlera e parashikuar është 30.500.000,00€ dhe LOT 2 “Rregullimi sekondar -LFC : Kosovë –Shqipëri” vlera e paraparë 5.500.000€**

Në fund të vitit 2013 është nënshkruar kontrata për LOT 1, me vlerë 29,255,022.74€ pa taksa doganore, pa TVSH pa shpenzime të interesit për kredi dhe pa shërbime konsulente. Fillimi i projektit është realizuar me vonesë për shkak të arsyeve të njohura të cilat kanë qenë jashtë ndikimit të KOSTT. Pas komisionimit zyrtarisht projekti është përfunduar me 18.12.2015, dy muaj para kohe.

Vlera Totale e investimit përfshirë taksat doganore dhe shërbime konsulentë është

LOT 1 = 33,291,739.48 €, që nënkupton rritje të vlerës së projektit.

- **LOT 2 “ Rregullimi sekondar -LFC : Kosovë –Shqipëri”, vlera e paraparë 5.500.000€**

Në vitin 2013 është nënshkruar kontrata për LOT 2 në vlerë 5.058.112,00€ pa taksa doganore dhe pa TVSH . Projekti ka përfunduar .

Vlera Totale e Projektit do të jetë përafërsisht **5,662,964.00€**, që nënkupton rritje të vlerës së projektit.

Bazuar në kontratë dhe kushtet e kontratës KOSTT ka pasë për obligim të paguaj edhe EC garancionin për pjesën e financimit me Kredi për LOT 1 dhe LOT 2 – si paket

Vërejtje : Për shkak të kushteve të marrëveshjeve për financim me kredi dhe donacion, parashihet edhe buxhet për vitin 2016 për dy LOT (LOT 1 dhe LOT 2)

- **Shpronësimi i Tokave për Linjën Kosovë - Shqipëri:**

Nga vlera 500.000 € është rritur buxheti në 1,300,000€, për shkak të servitutës që në fillim nuk është paraparë, por ka dale si ndryshim i ligjit.

- **Grupi i Projekteve i financuar nga IPA- 2011, 2012 dhe KfW - Kredi:**

1) Linja e re 110 kV NS Peja 3- NS 110/35 kV Peja 1 dhe ri-vitalizimi i NS Peja 1 (GIS); 2) Ri-vitalizimi i linjës 110 kV: L126/2 NS Peja 2- NS Deçan; 3) Ndërrimi i ndërprerësve në NS Prishtina 4; 4) Instalimi i OPGW në linjat interkonektive 400 & 220kV; 5) Inter OST grupet matëse në pikat interkonektive; 6) Instalimi i autotransformatorit të dytë ATR2, 300 MVA në NS 400/110kV Peja 3 dhe NS 400/110 kV Ferizaj2 ; dhe Shërbimet konsulente , vlera totale e planifikuar 30,850,000€.

Marrëveshja për financimin e këtyre projekteve është nënshkruar në mes KfW dhe KOSTT, KE ka dhënë donacion për projekte e Qeveria e Kosovës ka aprovuar kredinë për financimin e këtyre projekteve në katër LOT :

- **LOT 1 - Nënstationet -Vlera e projektit 7,599,902.00 €-**

- Ri-vitalizimi i NS Peja 1(GIS) ;
- Ndërrimi i ndërprerësve në NS Prishtina 4 ;
- Inter OST Grupet Matëse në pikat interkonektive;
- Fushat transformatorike 400/110kV për transformatorët ;

- **LOT 2 – Transformatorët - Vlera e projektit 4,443,000.00€**

- Instalimi i autotransformatorit të dytë ATR2, 300 MVA në NS Peja 3 dhe NS Ferizaj 2 ;

- **LOT 3 - Linjat transmetuese - Vlera e projektit 8,532,671.00€**

- Linja e re e 110kV e dyfishte NS Peja 3 - NS Peja 1;
- Revitalizimi i linjës 110kV LP 126/2 NS Peja 2- NS Decan
- Instalimi i OPGW në linjat interkonektive;

- **LOT 4 - Projekte shtese Vlera e projektit 10,794,071.00€**

- Rehabilitimi i nënstacioneve NS Viti , NS Lipjan , NS Klinë ;
- Rehabilitimi i shpenzimeve vehtijake AC/DC në nënstacionet 110kV ;
- SCADA /EMS në NS KOS B dhe sëndërtimi i SCADA lokale në NS Prishtina 5 dhe NS Podujeva;
- Transformatori dytë në NS Gjakova 1;

Grupi i projekteve të lartëshënuara ka ndryshuar edhe sipas grupizimit së përfshirjes së projekteve dhe vlerës Totale të projekteve; Vlera Totale e projekteve të nënshkruar është **31,369,645.00€** (pa shërbime doganore , ECA –garancionin ,shpronësim dhe servitut dhe shërbime konsulentë që ka vlerën përafërsisht **4,407,590.98 €**) .Këto janë paraqitur në formën tabelare si projekte të reja .

• **Grupi i Projekteve i financuar nga EBRD / Kredi (Q1 2016 - Q1 2019):**

Në grupin e Projekteve për përkrahjen e ngarkesës :

- Ndërtimi i NS 110/10(20) - Mitrovica 2 me linjat transmetuese 110 kV;
- Paket Projekti i NS 110/10(20) kV-Prishtina 6 me linjat kabllloviqe nentokesore 110 kV ;
- Paket Projekti i NS 110/10(20) kV-Fushë Kosovë me linjat transmetuese 110 kV; është shtuar edhe
- Paket Projekti i NS 220/10(20) kV-Drenasi 2 me linjat transmetuese 220 kV .
- Revitalizimi i NS 110/35/10kV Theranda dhe
- Ndërtimi i linjës së re NS Therandë – NS Rahovec

Tek ky grup i projekteve ka ndryshuar viti i realizimit, ndryshimi i burimi të financimit, grupizimi (LOT1,LOT2 dhe LOT 3) dhe shtimi i projekteve që ka rritur edhe vlerën totale të investimit si dhe për vitin 2013-2017. Vlera totale e planifikuar projekteve sipas grupizimit për tre LOT është 33,200,000.00€ pa taxat doganore ,shpronësimet dhe servitutën si dhe shërbimet konsulentë :

➤ **LOT 1 - Nënstacionet [110/10(20) kV - Vlera e projektit 17,200,000.00€**

- NS Prishtina 6 dhe 110 kV HIS në NS Prishtina 4;
- NS Fushë Kosova;
- NS Mitrovica 2 ;
- NS 220/10(20) kV - Drenasi 2 dhe
- Revitalizimi i pajisjeve TL në NS Theranda

➤ **LOT2 – transformatorët e fuqisë 40MVA Vlera Totale e planifikuar 6,600,000.00€**

- Në nënstacione NS Prishtina 6, 2x40 MVA në NS Fushe Kosova, 2x40 MVA në NS Mitrovica 2 dhe 2x40 MVA në NS Drenasi 2 ;

➤ **LOT 3 – Linjat transmetuese – Vlera totale e planifikuar -9,400,000.00€**

- Linja e dyfishtë kabllloviqe NS Prishtina 6 - NS Prishtina 4 ;
- Linja e dyfishtë kabllloviqe 110 kV NS Fushe Kosova;
- Linja e dyfishtë 220 kV Drenasi 2;
- Linja e dyfishtë kabllloviqe 110 kV Mitrovica2 dhe
- Linja e re e njëfishtë 110 kV NS Rahoveci - NS Theranda

Vlera prej 2,479,346.00€ për shërbimet konsulente , shpronësimet dhe servitut dhe taxa doganore për projektet e EBRD janë paraqitur në kuadër të projekteve të reja në tabelën e Planit Investiv 2013-2017

4.2 Projektet e reja gjatë vitit 2015

- **Software NEPLAN për DACF**

KOSTT është duke tentuar të plotësoj kërkesat teknike për t'u anëtarësuar në asociacionin e operatorëve të sistemit ENTSO-E.

Njëri prej kriterëve për tu plotësuar është edhe dërgimi i 24 vlerave të DACF (Day ahead congestion forecast) për KOSTT-in nëpërmjet EH . Kjo kërkesë del si obligim nga Policy nr.4 e Operational handbook të asociacionit ENTSO-E . Duhet të ceket se kjo kërkesë aplikohet për TSO anëtare dhe TSO të cilat pretendojnë të bëhen anëtare siç janë OST (Shqipëri), TELAS (Turqi) dhe një pjesë e Ukrainës të cilat sikurse edhe KOSTT-i punojnë në mënyrë paralele me ENTSO-E me seli në Zvicërr.

Përshkrimi teknik për këtë projekt përfshinë kërkesat teknike si: krijimi i modelit bazë të KOSTT-it (duke e ndarë përfundimisht nga modeli bazë i përfshirë nën modelin bazë të EMS-it Serbi), popullimi i tij me të dhënat për Sistemin elektro-energjetikë në përgjegjësi të KOSTT-it , krijimi i fileve të nevojshëm me të dhënat për shkëmbimin total të planifikuar për 24 orë , prodhimin e gjeneratorëve për 24 orë , topologjia e rrjetës (statusi kyçur/çkyçur) dhe faktorët e ngarkesës për nyjet e konsumit .

Implementimi i këtij projekti nënkupton aktivizimin e **NEPLAN** softwerit gjegjës, popullimin me të dhëna , definimin e nyjeve virtuale X , trajnimin dhe mirëmbajtjen vjetore.

- **Furnizimi me aksesore për vargje izolatorëve nga polimeri.**

Ky projekt ka për qëllim furnizimin me këta aksesore për nevoja të mirëmbajtjes së linjave të nivelit 110 dhe 220 kV.

Një pjesë e linjave transmetuese të KOSTT-it ju është ndërrua izolimi dhe nga izolatorët e porcelanit është kaluar në izolatorë polimeri.

Me herët ne jemi furnizuar me këta izolator dhe një sasi e mjaftueshme është si pjesë rezervë në depon kryesore të KOSTT-it ndërsa që këta izolatorë duhet të kombinohen edhe me aksesore tjerë siç janë :

- elektrodë për zbrazje
- pllakat shtjelluese.
- unazat për rregullim të fushës
- dhe pjesët tjera përbërëse të vargjeve.

Me qëllim të përdorimit në rastet e nevojshme të izolatorëve ata duhet të montohen bashkërisht edhe me aksesoret ndihmës.

- **Furnizimi me pjesë rezervë për linja dhe nënstacione,**

Ky projekt mundëson furnizimin me elemente të cilat janë të domosdoshme për funksionimin e aseteve më të rëndësishme të sistemit, kryesisht janë elemente lidhëse dhe profile të tipeve të ndryshme të shtyllave. realizimi i këtij projekti mundëson të furnizohemi me :

- Profile të ndryshme të shtyllave të linjave transmetuese
- Bulona dhe nënshtresa të tipeve të ndryshme,

- Kleme të ndryshme për nevoja të nënstacioneve dhe të linjave etj.

- **Rifreskimi dhe shtimi i moduleve të reja për MO,**

Ky projekt përfshinë redundancën e sistemi aktual të IT-së së tregut, implementimin e sistemit testues si dhe mirëmbajtjen e sistemit të IT-së.

- ✓ **Redundanca e sistemit**

Redundanca e sistemit është pjesë e projektit që parashikon që sistemi ekzistues i IT-së së tregut të ketë sistemin redundant në mënyrë që operimi i tregut të ketë besueshmëri të lartë. Në kushtet e tregut të lirë të energjisë elektrike nga sistemi për menaxhim të tregut kërkohet që të ketë besueshmëri të lartë dhe protokolli dhe siguria e shkëmbimit të të dhënave duhet të bëhet duke u bazuar në standardet dhe rekomandimet që i bënë ENTSO-E (European Network Transmission System Operator for Electricity – Rrjeti Europian i Operatorëve të Sistemit Transmetues).

Teknologjia e informacionit e tregut mundëson përmbushjen e obligimeve që dalin nga licenca e Operatorit të Tregut, Rregullat e Tregut, Kodet Teknike si dhe kërkesat që dalin nga direktivat, rregullativat Evropiane të cilat KOSTT si OST e Kosovës është e obliguar t'i përmbushë. Kërkesat kryesore që duhet të përmbush kjo teknologji e informacionit kanë të bëjnë me përmbushjen e standardeve nga doracaku i operimit të ENTSO-E.

Si pasojë e zhvillimeve drejtë liberalizimit të tregut të energjisë elektrike dhe integritetit të KOSTT në regjion është e nevojshme që Teknologjia e Informacionit e implementuar për Operatorin e Tregut të ketë sistemin e vetë redundant ("rezervë") që besueshmëria e operimit të sistemit të jetë maksimale.

Modulet kryesore të sistemit ekzistues të IT-së për të cilat kërkohet redundanca janë:

- Alokimi i kapaciteteve interkonektive të KOSTT dhe organizimi i ankandeve të kapaciteteve.
- Nominimi i programeve kontraktuale të palëve në treg dhe nominimi i transaksioneve ndërkufitare.
- Moduli i llogaritje ndërkufitare (UCTE accounting).
- Moduli i llogaritjes së jobalanceve.
- Barazimi financiar mes palëve në tregun e energjisë elektrike.
- Parashikimi i konsumit të energjisë elektrike.

- ✓ **Sistemi testues**

Si pjesë e këtij projekti është edhe instalimi i sistemit testues i cili do të jetë i nevojshëm për testime të skenarëve të ndryshëm të tregut që parashihen në zhvillimet e tregut të energjisë elektrike në Kosovë dhe Regjion si dhe do të mundëson trajnim adekuat të operatorëve të tregut për menaxhim të suksesshëm të tregut. Implementimi i sistemit testues do të zvogëlonte rrezikun e operimit të Operatorit të Tregut në proceset e tregtimit një ditë para operimit (në periudhën D-1).

- ✓ **Mirëmbajtja e sistemit –**

Në kohën e zhvillimeve dinamike që pritet të jenë sa i përket pozicionit të KOSTT-it në regjion dhe për shkak të nevojave për ndryshime në sistem është e nevojshme që sistemi të ketë mirëmbajtje adekuate. Mirëmbajtja do të përfshijë intervenime në sistem si dhe gadishmëri të stafit për intervenime në distancë. Intervenime në sistem do të bëhen ashtu siq kërkohen me nevojat imediate të tregut të energjisë elektrike.

4.3 Projektet e reja të vitit 2016

- **Realizimi i observimit të ndërsjellët të rrjetit transmetues në të KOSTT dhe CGES “Adaptimi i harduerit SCADA/EMS për plotësimin e kërkesave për ENTSO-E” dhe “Furnizimi me meter data collection”**

Projekti “Realizimi i observimit të ndërsjellët të rrjetit transmetues në KOSTT dhe CGES ka rrjedh si domosdoshmëri e plotësimit të kërkesave të ENTSO-E që të kemi marrëveshje të nënshkruara Nder-OST(Inter-TSO) si dhe të shkëmben të dhënat në kohën reale në mes të OST-ve të cilat kanë marrëveshjen e nënshkruar. Marrëveshjet e nënshkruara Inter-TSO kanë qenë kusht paraprak që të fillojnë negociatat e KOSTT-it me ENTSO-E për nënshkrimin e marrëveshjes së kyçjes së KOSTT-it në Rrjetin e ENTSO-E. Marrëveshje të njëjta janë nënshkruar edhe me EMS, MEPSO dhe OST. Shkëmbimi i të dhënave për observim në pajtim me Poliset 1 deri 6 të OH(Operational Handbook) të ENTSO-E duke përfshirë edhe polisen 6 si dhe Inter-TSO marrëveshjet KOSTT-EMS dhe KOSTT-MEPSO janë përfunduar gjatë vitit 2015. Po ashtu vitin e kaluar ka filluar edhe realizimi **“Realizimi i observimit të ndërsjellët të rrjetit transmetues në KOSTT dhe CGES (projekt i vitit 2015)”** ka filluar vitin e kaluar (2015) të realizohet dhe 95% të punimeve janë realizuar mirëpo për shkak të prishjes së një ICCP serveri në CGES nuk ka mundur të përfundojë. Ne presim që këtë vit të përfundojë edhe observimi me CGES. Observimi me OST është dike u finalizuar këto ditë dhe ka qenë pjesë e projektit të realizimit të linjës 400 kV Kosovë - Shqipëri.

- **Adaptimi i hardverit SCADA/EMS për plotësimin e kërkesave për ENTSO – E**

Ky projekt ka të bëjë po ashtu me plotësimin e obligimeve që KOSTT i ka marrë nga ENTSO-E si pjesë e road-map për anëtarësim në këtë organizatë. Pra, këtu kemi të bëjmë me shtimin e harduerit në platformën ekzistuese të sistemit SCADA/EMS për t'i përmbushur kërkesat teknike për shkëmbimin e sigurt dhe të besueshëm të informatave në mes KOSTT-it dhe ENTSO-E duke përfshirë të dhënat në kohën reale por edhe të dhënat të deponuara si proces i kohës reale. Këtu parashihet të vendosen Ruterat, Firewallat, Switchat në pajtim me normat teknike të ENTSO-E (Polica 6) si dhe Deponuesit e të dhënave të kohës reale – kërkesat që dalin nga polisa 1 –Operimi me LFC e kërkesa tjera nga poliset tjera të OH..

- **Furnizimi me meter data collection (20 copë)**

Ky projekt ka të bëjë me plotësimin e kërkesave nga Plosa 1 lidhur me kualitetin e matjeve në linjat interkonektive si dhe krijimin e matjeve bekap për funksionimin e LFC-AGC. Në kuadër të mirëmbajtjes së grupeve matëse si dhe ngritjes së besueshmërisë dhe performancës së sistemit të operimit në KOSTT si dhe kërkesave dhe obligimeve të reja që kanë dal nga projekti LFC-ja dhe ENTSO-E lidhur me ndërlidhjen e matjeve analoge çdo 1min për SCADA, e të cilat duhet të kenë saktësi minimum prej 1.5%, është paraqitur nevoja që të bëhen përgatitjet për funksionalizimin e këtyre kërkesave përmes ndërlidhjes së matjeve ekzistuese nga njehsorët e 20 (njëzetë)nënstacioneve distributive me sistemin ekzistues të SCADA-së në KCS përmes protokollit komunikues IEC 870-5-104 me kusht që ndërlidhja e nënstacioneve tjera të bëhet vitin tjetër.

Për të mundësuar ndërlidhjen e matjeve nga njehsorët dhe përkrahjen/përcjelljen e të dhënave nga njehsorët për sistemin e SCADA-së sipas protokollit IEC 870-5-104, është e nevojshme që të instalohen pajisje të veçanta të cilat mundësojnë ndërlidhjen e njehsorëve me sistemin e SCADA-së.

Pajisjet që mundësojnë këtë ndërlidhje të njehsorëve me sistemin e SCADA-së njihen me emrin **“Meter Data Collection”**.

Pajisja “Meter Data Collection – MDC” përdoret si një konvertor i protokollit DLMS të njehsorëve ekzistues në protokoll IEC 870-5-104 që është i përshtatshëm për SCADA.

Arsyeja e përzgjedhjes së këtyre pajisjeve është se janë të përshtatshme me infrastrukturën ekzistuese që tashmë është e instaluar në KOSTT dhe për shkak se komunikimi dhe bartja e të dhënave nga njehsorët për sistemin e SCADA-së bëhet direkt përmes protokollit IEC 870-5-104, pa pasur nevojë për pajisje tjera shtesë. Sasia e nevojshme e këtyre pajisjeve që nevojiten për të përfshirë të gjithë njehsorët është 20 **(10+1)** copë, respektivisht nga një pajisje të tillë për secilin nënstation dhe një si pjesë rezervë.

Këto pajisje do të instalohen nga stafi i Sektorit të Matjes në bashkëpunim me Sektorin e SCADA/EMS në kabinetet ekzistuese të njehsorëve.

- **Instalimi i kamerave vëzhguese në NS Prizren 2, NS Ferizaj 2 dhe NS Peja 3 –**

Ky është projekt që ka për objektiv rritjen e sigurisë së objekteve dhe operimit të paisjeve nëpër nënstatione. Projekti është vazhdimësi e projekteve të mëparshme të realizuara dhe tani në eksploatim në NS Kosova B me 2014 dhe NS Prishtina 4 dhe NS Kosova A në 2015. Për vitin 2016 kërkesa është për NS Prizreni 2, NS Ferizaj 2 dhe NS Peja 3.

- **Furnizimi me pajisje hardverike për nevojat të tregut**

Ky projekt është i rëndësishëm:

- Për shkak të detyrave të përditshme në lidhje me proceset e skedulimit, akountingut, ankandëve ditore/mujore dhe vjetore, intraday, qasjes në të dhënat dhe platformën e SEE CAO, qasja në të dhënat dhe platformën e OT etj.
- Për shkak të nevojës për të pasur një kompjuter rezervë nëse kompjuterët desktop për ndonjë arsye nuk funksionojnë, sidomos ditëve të vikendit e Shtunë dhe e Diel, ditëve të festave dhe gjatë mbrëmjes e jashtë orarit të punës kur ndonjë nga detyrat e lartpërmendura kërkohet të kryhen.
- Për të qenë në gjendje që t’iu qasen të dhënave të ndryshme nga cilido vend ku ndodhen qoftë përmes Internetit apo përmes fajllave të ruajtur në laptopët personal
- Për të bërë prezentimet e nevojshme përmes Power Point në konferenca, workshope, trajnime etj.

5.0 SHPENZIMET OPERATIVE

Për periudhën pesëvjeçare të kontrollit të çmimit, KOSTT-it janë lejuar 38,568,009.94 €. Të Hyrat në emër të Shpenzimeve Operative hyjnë Shpenzimet e Operimit dhe Mirëmbajtjes, Shpenzimet e Personelit, Shpenzimet e shërbimeve komunale dhe Shpenzimit tjera operative. Pas aplikimit të faktorit të efikasitetit keto shpenzime zvoglohen në 34,210,988.94 €, që do të thotë se KOSTT-it në emër të faktorit të efikasitetit ju kanë zbritur të hyrat për 4,357,021.00 €. KOSTT vlerëson se arritja e këtij niveli të efikasitetit është praktikisht e pamundur për shkak të natyrës së kufizuar të veprimeve ku mund të arrihet efikasiteti.

Për vitin 2015 në veçanti KOSTT-it i janë lejuar 7,733,808 €, vlerë e cila pas aplikimit të faktorit të efikasitetit ka rënë në 6,884,474 €, e cila edhe është përfshirë në të hyrat maksimale të lejuara. Total Shpenzimet e Realizuara në vitin 2015 janë 7,402,488 €.

Për vitin 2016 kërkesa për shpenzime operative është 7,923,600 €.

Ne vijim paraqiten raportimet, sqarimet dhe kërkesat në veçanti për secilën kategori të Shpenzimeve Operative.

5.1 Shpenzimet e Personelit

Shpenzimet e realizuara të personelit për vitin 2015 janë 5,030,004 €. Kurse ato të planifikuara për vitin 2016 janë 5,177,600 €, ku përfshihen shpenzimet për paga, tatime dhe kontribute; kontrata në vepër për pagat për Bordin e Drejtoreve dhe disa kontrata tjera në vepër; shpenzimet e performancës. Rritja e kërkuar në krahasim me vitin 2015 është reflektim nga përfshirja e kriterit të rrezikshmërisë së vendeve të punës në pagat baze në harmoni me ligjin mbi vlerësimin e rrezikshmërisë së vendeve të punës. Një element ndikues është edhe implementimi i dispozitave të Marrëveshjes Kolektive të cilat kanë të bëjnë me pagesën e përvojës së punës sipas viteve të përvojës nga 0,3% në 0,5%.

Në mënyrë që kompania të mund të motivojë personelin e vet për efikasitet të mëtutjeshme, të paraqitet në tregun e punës si punëdhënës konkurrente ashtu siç është kompani konkurrente në Rajon e me gjërë, të zhvillojë personelin krahas kërkesave të reja në sektorin e energjisë, në mënyrë që të jetë në nivelin mesatarë në Rajon e jo në nivelin më të ulët, KOSTT' kërkon që t'i aprovohet kërkesa për buxhetin e personelit për vitin 2016.

Duhet të ceket se KOSTT në një pjesë të veprimtarisë së vet konsiderohet si një prej kompanive që i nënshtrohet rrezikshmërisë më të lartë në vendin e të punës.

KOSTT dëshiron të vejë në pah se viteve të fundit përveç shkurtimit të buxhetit të personelit që është aplikuar në vitin 2011, nuk iu ka lejuar asnjë rritje pavarësisht krizës globale, rritjes së çmimeve, rritjes së inflacionit etj. KOSTT në mënyrë që të jete në gjendje t'a mbajë nivelin aktual të efikasitetit në punë dhe vendin e vet të merituar si kompani publike me e suksesshme në Kosovë, kërkon nga ZRrE që kjo kërkesë t'i aprovohet.

Duke marrë parasysh se KOSTT është një prej OST-ve më eficiente në rajon, ku mund të përmendim një prej indikatorëve të matshëm nivelin e humbjeve në transmision i cili është më i ulët në krahasim me të gjitha OST-të e rajonit, performanca e operimit të sistemit është prej më të lartave në Rajon, atëherë KOSTT pret që edhe paga mesatare e personelit të vet t'i afrohet pagës mesatare të OST-ve të rajonit.

5.2 Shpenzimet e Mirëmbajtjes

Shpenzimet e Realizuara të Mirëmbajtjes gjatë vitit 2015 janë 597,064 €, kurse të Lejuara kanë qenë 1,490,539€. Për vitin 2016 janë planifikuar 908,000 €.

Në këtë kategori KOSTT ka arritur një efikasitet të lartë dhe pjesën e mbetur të kësaj kategorie e ka rialokuar dhe shpenzuar në kategori tjera operative.

5.3 Shpenzimet tjera operative

Shpenzimet tjera operative për vitin 2015 janë realizuar së bashku me shërbimet komunale 1,775,430€ kurse të lejuara sipas pesëvjeçarit për këtë kategori janë 1,853,413€. Për vitin 2016 planifikohen 1,838,000 €.


5.4 Shpenzimet e Humbjeve në Transmision

Niveli i Lejuar i Humbjeve në Transmision për vitin 2015 ishte 1.80% e energjisë së transmetuar për qëllim të konsumit të Kosovës. Kjo e shndërruar në vlerë absolute sipas rrjedhave të parashikuara të energjisë ishte 110.9 GWh. Me një çmim të humbjeve prej 28.25 €/MWh, të hyrat e lejuara për humbjet në transmision për vitin 2015 kanë qenë 3,132,471€.

Gjendja aktuale sa i përket kostonë së humbjeve në transmision është si vijon. Niveli i realizuar i humbjeve në transmision (sipas matjeve) është 110.012 GWh, përkatësisht 3,075,667 €.


Në bazë të Balancës së Aprovuar Vjetore të Energjisë Elektrike, humbjet e parashikuara për vitin 2016 do të jenë 113.9 GWh.

Fig. 1. Humbjet e Lejuara dhe të Realizuara 2007 – 2015 në GWh



Kategoria e humbjeve është pika më efikase ku KOSTT ka treguar performancë të lartë. Nëse shikohet trendi i humbjeve shihet që humbjet nga vlera 266.6 GWh në vitin 2007 kanë rënë në vlerën 110 GWh. Mirëpo humbjet në transmision janë në nivelin minimal dhe nuk pritet që trendi i zvogëlimeve të vazhdojë për shkak të aspektit fizik.

Fig 2. Humbjet në transmision në Rajon dhe më gjerë



Ashtu siç e kemi cekur shumë herë se efienca e KOSTT sa i përket humbjeve në transmision është e jashtëzakonshme, e dëshmon edhe Fig. 2, e punuar me të dhënat e marra nga Raporti i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë. (Përqindja e llogaritur për Kosovë përfshinë tranzitin e energjisë)

Në raportin e publikuar për humbjet në transmision nga National Grid i Britanisë së Madhe paraqiten humbjet për vitin 2014/2015 ku niveli i realizuar i tyre është 1.84%, që d.m.th, humbjet në transmision në Kosovë janë në nivel shumë më të favorshëm. Ndërsa në Raportin Vjetor 2014 të publikuar nga ELES në Slloveni shihet se kostoja e humbjeve në transmision përbën 23% të të hyrave totale, kurse në KOSTT sipas vlerave të lejuara për 2015 përbën rreth 12%.

Të gjitha këto sa u thanë më lartë vërtetojnë pohimin e KOSTT se niveli i lejuar i humbjeve në transmision është shumë i vogël.

KOSTT edhe vitin e kaluar e ka sqaruar se ky nivel i lejuar i humbjeve është me rrezik për kompaninë duke marrë parasysh se niveli i humbjeve në transmision teknikisht iu ka afruar nivelin të skajshëm më të ulët të humbjeve, ku zvogëlimi i mëtutjeshëm i tyre paraqitet pothuajse i pamundur. Trendi i zvogëlimit të humbjeve i cili ekzistonte deri më tani ka ndryshuar me ndryshimin e konfigurimit të rrjetit. Trendi i humbjeve siç edhe po shihet ka filluar të ngritet dhe në vitet në vijim do të jetë në ngritje. Kjo për shkak të shumë faktorëve të cilët janë të parashikueshëm, si faktori i ngritjes së kërkesës dhe pikut, gjithashtu një sërë projektesh të cilat do të zhvillohen për të përmirësuar sigurinë në sistem dhe për të plotësuar kushtin N-1 si dhe faktorëve të parashikueshëm siç ishte vitin e kaluar shpërthimi në TC Kosova A.

KOSTT nuk dëshiron që ky nivel i ulët i caktuar i humbjeve të mbetet duke e mbajtur kompaninë në rrezik të vazhdueshëm financiarë nga faktorë që janë jashtë ndikimeve të tij.

5.5 Shpenzimet e Shërbimeve Ndhmëse

Me qëllim të operimit stabil dhe të besueshëm të sistemit elektroenergjetik, KOSTT është i obliguar të sigurojë shërbimet e nevojshme ndihmëse për sistemin elektroenergjetik. Në shërbimet ndihmëse përfshihen shërbimet për sigurimin e rezervës sekondare dhe rezervës terciare.

1. Rezerva sekondare (rregullimi fuqi - frekuencë)

Qëllimi i Rezervës së Rregullimit Sekondar është që ta rikthejë frekuencën dhe shkëmbimin ndërkufitar në vlerat fikse referente dhe të lirojë Rregullimin Primar.

Sipas ENTSO-E¹ çdo TSO duhet të sigurojë së paku Rezervën e Rregullimit Sekondar të llogaritur sipas :

$$R = \sqrt{a L_{\max} + b^2} - b$$

R – Vlera minimale e Rregullimit sekondar

L_{max} – Ngarkesa pik në zonën rregulluese

a = 10 MW ; b = 150 MW

Rregullimi Sekondar duhet të përdoret vetëm me qëllim të korrigjimit të ACE.

KOSTT do të kërkojë prokurimin e kapacitetit të njëjtë për rregullim ngritës dhe rregullim zbritës dhe kjo sasi do të jetë për një sasi të caktuar për çdo muaj .

Tabela 2. Vlerat e planifikuara të Rezervës së Rregullimit Sekondarë për KOSTT gjatë 2016² :

2016	Janar	Shkurt	Mars	Pril	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
L _{max} (MW)	1129	1029	997	937	718	697	707	707	738	868	966	1125
R _s (±) (MW)	34	31	30	29	22	22	22	22	23	27	29	34

Në Marrëveshjen për Shërbimet Ndhmëse të nënshkruar me OST-në nga Shqipëria më 17 dhjetor 2015, sasia e kontraktuar e Rezervës së Rregullimit Sekondar është (±) 25 MW. Kjo Marrëveshje pritet të implementohet me fillimin e operimit të KOSTT si zonë rregulluese e pavarur. Sipas kësaj marrëveshje kostot e rezervës sekondare në vlerën (±) 25 MW do të jenë të njëjta me koston që do të paguaj OST për të siguruar këtë rezerve nga burimet gjeneruese në Shqipëri.

¹ Operation Handbook – Policy 1 B-D 5.1

² Balanca vjetore e energjisë elektrike 2016

Rezerva terciare ka më shumë se një kërkesë:

- Zëvendësimin e rezervës sekondare pas rreth 15 minutash për ti mundësuar ofruesit të rezervës sekondare kthimin në gjendjen e mëparshme të gatishmërisë; kjo kërkesë vlen për rregullim ngritës dhe rregullim zbritës.
- Zëvendësimin e furnizimit të energjisë pas rënies së njësisë më të madhe gjeneruese – kjo është kërkesë vetëm për rregullimin ngritës;
- Balancimin e sistemit në ditën e realizimit të shkaktuar nga parashikimi i keq i konsumit ose për shkak të ndryshimit të paparashikuar të prodhimit të erës – ky element i shërbimit gjithashtu mund të ofrohet nëpërmes mekanizmit balancues dhe është kërkesë për rregullim ngritës dhe rregullim zbritës;
- Rregullimi zbritës për balancim të sistemit gjatë natës për shkak të tepricave të energjisë bazë (kjo nuk duhet të ndodhë në një treg plotësisht funksional ku pjesëmarrësit duhet të kontraktjnë shitjen e tepricave të energjisë e jo ta shtyjnë atë në sistem).

Tabela 3. Vlerat e planifikuara të Rezervës së Rregullimit Terciar për KOSTT gjatë 2016 (si vlerë e rezervës terciare është marrë fuqia në dispozicion e njësisë më të madhe prodhuese)³ :

2016	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Rs (±) (MW)	264	264	264	264	264	264	264	264	264	264	264	264

KOSTT do të kërkojë prokurimin e rregullimit ngritës të mjaftueshëm për zëvendësimin e daljes nga sistemi i njësisë gjeneruese dhe atë jo tërë rezervën e paraparë 264MW por vetëm për sasinë e kapacitetit prej 150MW për 4 orë.

Në mungesë të ndonjë inputi tjetër, për çmimet e këtyre shërbimeve e si rrjedhojë llogaritjen e këtyre kostove si tërësi, KOSTT vazhdon të mbështetet në studimin e të paraqitur në dokumentin "Ancillary Services Revenues and Costs" të përgatitur nga konsulenca ECA, dhjetor 2014, sipas të cilit janë parashikuar edhe kostot për vitin 2015.

Në të Hyrat e KOSTT-it për vitin 2015 janë përfshirë edhe të hyrat prej 3,865,000.00 € për kostot e parashikuara të shërbimeve ndihmëse. Gjatë vitit 2015 nuk ka ndodhur shpenzimi d.m.th. këto kosto nuk janë realizuar.

Arsyeja e mosrealizimit të këtyre kostove është pamundësia e KOSTT-it që të fillojë të operoj si zonë rregulluese. Sipas marrëveshjeve me ENTSO-E, KOSTT është dashur të fillojë të operoj si zonë rregulluese nga muaji Qershor 2015 por, për shkak të obstrukcioneve të bëra nga EMS dhe ndikimi politik i Serbisë ka ndodhur shtyrja e fillimit të operimit të KOSTT si zone rregulluese fillimisht deri

³ Balanca vjetore e energjisë elektrike 2016

me 29.11.2015 dhe vazhdon ende. Implementimi i shërbimit të rregullimit sekondar me OST është i mundur vetëm nëse KOSTT fillon të operoj si zonë rregulluese/bllok rregullues. .

Pra, realizimi i këtyre kostove ka qenë jashtë kompetencave dhe faktorëve ndikues të KOSTT andaj edhe përgjegjësia nuk bie mbi kompaninë.

Meqenëse ende nuk ka të dhëna historike mbi kostot e këtyre shërbimeve dhe referenca nga Tregu në Kosovë atëherë vlera parashikimit për kostot e këtyre shërbimeve për vitin 2016 mbeten e njëjta me ato nga ato të vitit 2015 qe janë bazuar mbi studimin e cekur më lartë.

Duke marrë ne konsiderim të gjitha informacionet e dhëna me lart ne lidhje me pamundësinë e realizimit të kostove të shërbimeve ndihmese, KOSTT i drejtohet ZRrE me kërkesën për mbajtjen e të hyrave nga viti i kaluar.

5.6 Faktori i Efikasitetit

Çdo vit që nga fillimi i periudhës pesëvjeçare të kontrollit të çmimit në vitin 2013, KOSTT ka paraqitur fakte dhe arsyetime të shumta që niveli i përcaktuar i këtij faktori të efikasitetit prej 4% është shumë i lartë dhe i papërballueshëm për kompaninë, duke marrë parasysh faktorë të ndryshëm ndikues, si faktorë të jashtëm, të brendshëm, teknikë, politik financiarë e të tjerë.

Gjatë gjithë vitit kalendarik 2015 KOSTT ka ndërmarrë masa për shkurtimin e shpenzimeve, rishikimin e pozicioneve shpenzuese, kursime në kategori, rialokim të shpenzimeve e masa tjera por prapë nuk ka arritur ta realizojë cakun prej 4%.

Efekti negativ financiarë i paraqitur gjatë këtij viti si pasojë e këtij faktori është 190,010 €.

Rikthehemi prapë me kërkesën e rishqyrtimit të këtij faktori dhe vendosjen e tij në parametra real.

Tabela 4. Faktori i Efikasitetit dhe ndikimet e tij

	2013	2014	2015	2016	2017	TOTAL
TOTAL SHPENZIMET OPERATIVE TË PARASHIKUARA	7,523.29	7,633.60	7,733.81	7,798.61	7,878.71	38,568.01
TOTAL SHPENZIMET OPERATIVE TË LEJUARA PAS FAKTORIT TË EFIKASITETIT	7,222.36	7,039.36	6,853.99	6,642.04	6,453.25	34,210.99
EFICIENCA QË DUHET TË ZBATOHET NDAJ KËTYRE SHPENZIMEVE 4 %	302.93	594.24	879.82	1,156.57	1,425.46	4,357.02
<i>Shpenzimet e realizuara</i>	7,487.15	7,577.26	7,402.49	7,923.60	7,923.60	38,314.19
<i>Mungesa/Teprica</i>	(264.79)	(538.00)	(548.50)	(1,281.56)	(1,470.35)	(4,103.20)
Shpenzimet pas faktorit të supozuar të efikasitetit 1% nga KOSTT	7,448.06	7,482.03	7,504.90	7,491.72	7,493.03	37,419.73
<i>Eficienca e supozuar 1%</i>	75.23	151.57	228.91	306.89	385.68	1,148.28
<i>Mungesa/Teprica</i>	(39.09)	(95.33)	102.41	(431.88)	(430.57)	(394.46)

KOSTT duke u bazuar në të gjitha faktet e përmendura si dhe gjendjen e ndodhur financiare dhe teknike gjatë vitit 2013, 2014 dhe 2015, përsëri i drejtohet Zyrës së Rregullatorit me kërkesën për

Faktorin e Efikasitetit prej 1%, edhe pse edhe ky nivel i faktorit na paraqet gjendjen negative në kesh, do të ishte disi e menaxhueshme duke përdorur burime tjera për mbulesë.

6.0 MEKANIZMI I KOMPENZIMIT NDËR TSO - MEKANIZMI I ITC

Nga 01.01.2016 KOSTT është pjese e ITC mekanizmit. . KOSTT është informuar nga ENTSO-E se është pranuar ne mekanizmin e ITC dhe KOSTT ka nënshkruar marrëveshjen multilaterale – MLA të ITC. Administratori i ITC duke filluar nga 01.01.2016 do të llogarit për KOSTT kontributet që KOSTT duhet të paguaj në fondin e ITC për NEF (net eksport flow) dhe NIF (net import Flow) dhe kompensimin që KOSTT duhet të marrë transitin e energjisë elektrike në rrjetin transmetues horizontal. . Me këtë mekanizëm KOSTT do te marre te hyra ne emër te transittit dhe humbjeve ne rrjetin e Kosovës dhe do te paguaj ne emër te humbjeve dhe tranzititit te shkaktuar ne rrjetin horizontale te TSO-ve tjera për import dhe eksport te energjisë. Si rezultat i llogaritjeve të përafërta dhe varësisht rrjedhave të tranzitit dhe NEF dhe NIF KOSTT për muaj të caktuar mund të jetë net pozitiv (të marr të hyra nga fondi ITC) ose net negativ (të paguaj në fondin e ITC)

Në bazë të llogaritjeve të përafërta në tabelën më poshtë është llogaritur net pozita e KOSTT për vitin 2011 deri në vitin 2014 duke u bazuar në raportet e ACER.

Meqenëse nuk ka të dhëna historike dhe është vështirë të parashikohet transiti dhe humbjet në transit, atëherë trajtimi i këtyre te hyrave/kostove, propozohet te behet procesin e ardhshëm të përshtatjeve, ku KOSTT do te informoj ZRRE por gjendjen neto ne fund te vitit.

7.0 PËRMBLEDHJE

KOSTT është ndër OST-të më efikase në rajon sa përket efikasitetit të humbjeve dhe performancës së operimit kurse ka tarifën mesatare ndër më të ulëtat në rajon.

Në vazhdim paraqitet analiza e zhvillimit të trendëve të tarifës së transisionit përkitazi me zhvillimin e aseteve dhe shpenzimeve.

Fig.3. Trendet e Zhvillimit të Tarifës së transmissioinit, asetëve dhe shpenzimeve 2007 – 2015




Tabela 3. Trendet e Zhvillimit të Tarifës së transmissioinit, asetëve dhe shpenzimeve 2007 – 2015

			2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Tarifa Mesatare	10 ⁻⁴	€ /kWh	30,694.30	31,354.60	40,479.40	35,312.00	26,312.30	32,800.90	30,161.80	25,977.30	34,000.30
Asetet	10 ⁹	€/000	30,731.00	48,336.00	75,241.00	88,827.00	95,558.00	116,693.00	126,871.00	130,421.00	164,554.63
Shpenzimet Operative	10 ¹	€/000	27,217.00	31,622.30	31,208.30	41,454.70	21,457.60	22,546.90	29,105.30	24,520.00	23,724.84
Humbet	10 ¹	€/000	71,642.80	58,293.90	55,090.00	44,161.30	35,789.40	34,334.30	34,269.90	34,280.90	30,736.67
Personeli	10 ¹	€/000	14,710.00	19,826.00	22,830.00	24,883.30	24,441.20	38,713.70	44,485.10	50,141.30	30,300.04

* Me qëllim që raporti në mes të segmenteve të krahasuara të jetë më i dukshëm në diagram vlerat janë indeksuar sipas nevojës.

Diagrami i paraqitur është një pasqyrë shumë e qartë e efektivitetit të kompanisë KOSTT. Zhvillimi i asetëve ka shkuar proporcionalisht me zvogëlimin e humbjeve deri në pikën më të ulët të mundshme teknikisht gjë e cila nuk ka ndodhur me të licencuarit tjerë. Shpenzimet e personelit janë zhvilluar me një rritje të lehtë vit pas viti përveç vitit 2012 ku rritja e menjëhershme paraqet kalimin e operatorëve nga KEK në KOSTT. Shpenzimet tjera operative që nga viti 2010 kanë shënuar zbritje.

Gjatë gjithë kësaj periudhe me zhvillime të asetëve për më shumë se 500% në krahasim me vitin 2007, rritjes së numrit të personelit për 100% arritjes së performancave të shkëlqyera teknike dhe operative, Tarifa mesatare e transmissioinit ka mbetur pothuajse e njëjtë me lëvizje shumë të vogla poshtë, lartë, gjatë viteve.



Duke marrë parasysh të gjitha faktet e paraqitura deri këtu, KOSTT beson se aprovimi i kërkesave të paraqitura është i domosdoshëm.

- Fundi i Dokumentit -